



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 253/2019  
Datë: 12 dhjetor 2019

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e 227-të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Anëtarë për të shërbyer në Panelin Hetimor në lëndën Nr.AD/KGJK/12/GJTHPR-ADGJTHP.nr.16/2019, caktohen gjyqtarët:
  - Bekim Salihu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj, kryesues;
  - Diellza Hoxha, Gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, anëtare;
  - Sahit Krasniqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, anëtar;
  - Agim Maliqi, Gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës, anëtar rezervë;
  - Drita Rexha, Gjyqtare në Gjykatën e Apelit, anëtare rezervë.
  
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, sipas nenit 11 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve, që janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që do të hetohet.

Paneli Hetimor zhvillon hetimin bazuar në nenin 12 paragrafi 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethanat të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit, Këshilli mundë t'i zgjasë mandatin panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.

Skender COÇAI,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Arkivit.